



Si mund të merret një vizë Shengen

Marrëveshja e Lehtësimit të Vizave lidhur mes BE-së dhe Shqipërisë parashikon këto procedura dhe dokumenta që biznesmeni (ortaku, administratori ose një i punësuar pranë shoqërisë tregtare) duhet të plotësojë gjatë aplikimit pranë shërbimit konsullor të Shtetit Anëtar të BE-së:

DOKUMENTAT QË DUHEN

Një kërkesë me shkrim nga pala mikpritëse që mund të jetë një person juridik, një shoqëri tregtare, autoritet shtetëror apo organizatorë të ekspozitave tregtare dhe panaireve etj, **e vërtetuar me notë verbale nga Dhoma e Tregtisë anëtar i së cilës jeni.**

Çfarë përmban kërkesa me shkrim?

- Për personat e ftuar: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, seksin, shtetësinë, numrin e dokumentit të identifikimit, kohën dhe qëllimin e udhëtimit, numrin e hyrjeve.
- Për personin juridik që bën ftesën: emrin, mbiemrin e plotë dhe adresën, emrin dhe pozicionin e personit që firmos kërkesën dhe numrin e regjistrimit për kompanitë me seli në Shtetet Anëtare.

Megjithatë, të gjitha kërkesat e tjera për paraqitjen e dokumentave mbi mjetet tuaja financiare të përballimit të shpenzimeve të qëndrimit dhe udhëtimit, mbeten të pandryshuara me marrëveshjen e re dhe kërkohen që të kontrollohen në konsullatën në të cilën ju aplikoni.

AFATI I VLEFSHMËRISË SË VIZËS

- Një vizë me shumë hyrje por qëndrim të shkurtër, **e vlefshme deri në një vit**, duhet t'ju lëshohet nëse:
 - gjatë vitit të mëparshëm ju keni marrë të paktën një vizë;
 - ju e keni përdorur atë në përputhje me ligjet e hyrjes dhe të qëndrimit të Shtetit Anëtar të BE-së të vizituar ;
 - keni arsye për të kërkuar një vizë me shumë hyrje, dhe udhëtoni rregullisht në Shtetet Anëtare në BE.
- Një vizë me shumë hyrje, **e vlefshme minimumi 2 vjet dhe maksimumi 5 vjet**, duhet t'ju lëshohet nëse:
 - gjatë viteve të fundit ju keni përdorur viza njëvjeçare me shumë hyrje në pajtim me ligjet e hyrjes dhe qëndrimit të Shtetit Anëtar të BE-së të vizituar nga ju dhe;
 - Arsyet për të kërkuar një vizë me shumë hyrje janë akoma të vlefshme.

Tarifa për të përpunuar aplikimin për vizë është **35 euro**. Zyrat konsullore të Shteteve Anëtare të BE-së do të marrin vendimin për të lëshuar një vizë **brenda 10 ditëve kalendarike** që nga data e marrjes së aplikimit dhe dokumentave të kërkuara për të.

Anëtarësimi në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë për vitin 2008 ju ndihmon në marrjen e vizës drejt vendeve të BE-së.